



Gjatë muajit shtator Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) ka zhvilluar gjashtë mbledhje, gjatë të cilave u licencuan dy subjekte në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe një subjekt në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, u vendos mbi licencimin e **Bursës Shqiptare të Energjisë - ALPEX**, në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë. Në total prodhimi vendas u shtua me një kapacitet 58.864MW.

MBLEDHJE BORDI



ERE miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Gusht 2022, prej:

- 31.29 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.26 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për periudhën 01.08.2022 – 31.12.2022

Këto janë çmimet që do të aplikohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (funksion që aktualisht ushtrohet nga ana e FSHU) për të gjithë konsumatorët që nuk kanë arritur të gjejnë një furnizues në treg të lirë dhe marrin shërbimin e furnizimit në kushtet e shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit.

FMF GUSHT

Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh në muaj.

Mbas shqyrtimit të kësaj kërkesë, Bordi i ERE-s pranoi pjesërisht kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a, duke vendosur të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë prej 42 lekë/kWh, nga ai i kërkuar prej 42.95 lekë/kWh nga shoqëria FSHU sh.a. Ky çmim do të jetë i aplikueshëm për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor 2022 dhe do të ketë efekte vetëm për fashën e konsumit mbi 800 kWh/muaj. Për të gjithë klientët familjarë, sasia e energjisë prej 800 kWh e konsumuar gjatë çdo muaji, do të mbetet e njëjtë pra 9,5 lekë/kWh. Bordi i ERE-s gjithashtu kërkoi nga shoqëritë OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. që periodha e leximit periodik të matësit të energjisë elektrike të klientëve familjarë, duhet të kryhet duke respektuar në mënyrë rigorozë afatin prej 30 ditësh kalendarike, të përcaktuar në nenin 11 të “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, me qëllim mbrojtjen e të gjithë klientëve familjarë nga çdo abuzim i mundshëm i leximit dhe faturimit të konsumit të energjisë elektrike.

Në vijim, në kushtet që kosto e blerjes së energjisë elektrike të FSHU sh.a. në zbatim të VKM 456/2022 vijon të jetë ajo e miratuar nga Asembleja e Përgjithshme e Aksionarit të KESH sh.a. prej 2.6 lekë/kWh, për të gjithë konsumatorët të cilët shërbehen në kushtet e shërbimit universal, ERE vlerësoi përsëri kërkesën e FSHU sh.a., për ndryshimin e vendimit Nr. 242, datë 23.09.2022, “Mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekë/kWh për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2022”, duke lënë në fuqi **për muajin tetor 2022, çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët familjarë, në masën 9.5 lekë**, siç miratuar me anë të vendimit Nr. 74/2022 të Bordit të ERE.

Në situatën e emergjencës energjitike që ndodhemi, rishikimi i çmimeve do të jetë periodik, pra nëse Furnizuesi i Shërbimit Universal do të njoftojë për kosto të ndryshuara të çmimit të blerjes së energjisë, atëherë do të reflektohen dhe nga ERE.

Njoftimin e plotë mund ta lexoni në linkun bashkëngjitur.

<https://ere.gov.al/sq/publikime/njoftime>



NEWSLETTER

SHTATOR 2022

Nga data 29.09.2022
në faqen zyrtare të
Entit Rregullator për
Energjinë, mund të
gjeni të detajuar
Bilancin Energjistik të
8 - muorit për vitin
2022 (MWh).

Bashkangjitur dhe
linku në të cilin mund
të lexoni më shumë:

https://www.ere.gov.al/images/files/2022/10/12/PUBLIKIM_8-M_2022_001.pdf



ANKESA

Gjatë muajit shtator, pranë ERE-s janë adresuar për zgjidhje 22 ankesa. Në zbatim të rregullave për shqyrtimin e ankesave të miratuara nga ERE, është vijuar puna për shqyrtimin e tyre dhe plotësimin e dokumentacionit në rastet e konstatuara në mungesë, nga ana e të licencuarve përgjegjës si dhe më tej është proceduar me shqyrtimin e fakteve dhe shpjegimeve të palëve, për të dalë në fund me gjetet e ERE në lidhje me secilën ankesë. Në çdo rast ERE ka bërë me dije konsumatorët në lidhje me gjetjet e të licencuarit përgjegjës kur ka qenë ky i fundit që ka proceduar me veprime korigjuese, apo urdhërat e ERE për ndërmarrjen e veprimeve korigjuese nga ana e të licencuarit kur është konstatuar rrethana.

Nga të gjitha ankesat e administruara përgjatë muajit shtator konstatohet se janë kryesisht me objekt:

·mbifaturim, për rethanat kur dyshohet se energjia e faturuar nuk përputhet me energjinë e matur;

·dëm ekonomik, cka konstatohet në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme nga ana e konsumatorëve në rrjetin e shpërndarjes;

·vlerë referuese, për rethanat kur operatori i rrjetit konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesimi në të dhënat e matjes).

